Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Sahit Beqiri	**13.12.2023**	**17.12.2023**	**2023/1003**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **11.12.2023**, OE: **Q.M. "Tema" - Ferizaj**, ka parashtruar ankesë me nr: **2023/1003**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë GOE: **"MOVIOLA" L.L.C. & Platform Advertising L.L.C - Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Prodhimi i videove promovuese"** me nr. të prokurimit: "**216-23-10667-2-2-1**", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**, lloji i kontratës: **Kontrat publike kornizë - shërbim**, vlera e parashikuar e kontratës: **120,000.00 €**. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë **NUK** është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankese)

*__Nenet 1__,__6__, __7__, __10__, ***28,*** __54__, __56__, __59__, __66, 67, 68__ të Ligjit **Nr.04/L-042** për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin **Nr. 04/L-237**, ligjin Nr. **05/L-068** dhe ligjin **Nr.05/L-092**

* **Neni 48** i Ligjit **Nr.05/L-031** Për Procedurën e Përgjithshme Administrative

*** Neni 21** Ligjit nr. 04/L-044 Për Komisionin e Pavarur të Mediave

* Rregullore Nr.001_2022 Prokurimin Publik, Nenet 24.7, 25.9 Faza e Rishqyrtimit të Vendimit të AK (shkeljet shtesë):

Neni 108/A të Ligjit **Nr.04/L-042** për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin **Nr. 04/L-237**, ligjin Nr. **05/L-068** dhe ligjin **Nr.05/L-092**

Neni 40 i Rregullores Nr.001_2022 Për Prokurimin Publik

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet

Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58), i publikuar nga AK Ministria e Punëve të Jashtme –MPJ më datë 21.11.2023, si dhe Letra Standarde (B42) për operatorin e eliminuar drejtuar OE Q.M. "TEMA" O.P., lidhur me Aktivitetin e Prokurimit nr. 216-23-10667-2-2-1 me titull "Prodhimi i videove promovuese", përmban shkelje esenciale të Neneve 1, 6, 7, 10, 28, 54, 56, 59, 66, 67 dhe 68 të LPP-së, sepse në mënyrë të pabazuar e ka eliminuar Q.M "TEMA" O.P nga tenderi, përkundër faktit se ky OE i ka plotësuar të gjitha kriteret e përzgjedhjes dhe dhënies, ndërsa ka shpërblyer me kontratë një operator ekonomik të papërgjegjshëm, i cili ka ofruar ofertë më të shtrenjtë (Neni 6 i LPP).

Në këtë aktivitet prokurimi, AK MPJ nuk ka i përfillur rregullat dhe procedurat e e zbatueshme, obligime që përshkruhen sipas Nenit 1 të LPP-së.

ARSYETIM

Pretendimi nr.1 – Vërtetim i gabuar i gjendjes faktike, Nenet 28, 54 dhe 59 të LPP dhe Neni 48 i LPPA

Pas analizës së provave, dëshmive dhe fakteve nga dokumentacioni i tenderit, kemi ardhur në konstatim se Komisioni Vlerësues i AK MPJ, në takimin e mbajtur më 20.11.2023, gjatë vlerësimit të ofertës sonë, ka bërë vërtetim të gabuar të provave dhe gjendjes faktike, duke e shpallur OE Q.M. "TEMA" O.P. si operator të papërgjegjshëm, në kundërshtim me Nenin 59 të LPP-së, përkundër faktit se tenderi i këtij operatori i ka plotësuar të gjitha kriteret e përzgjedhjes dhe dhënies, të parapara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të Tenderit.

Në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, duke iu referuar mospërmbushjes së kërkesave për ofrim tëdëshmive sipas Nenit 65, AK MPJ e jep këtë arsyetim: "Edhe pas sqarimeve të pranuara nga ana e juaj, nuk plotësoni kërkesën lidhur me aftësinë teknike dhe/ose profesionale. "OE-i duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar projekte te ngjashme në tri vitet e fundit në minimum 120,000 euro." Kontrata me Komunën e Ferizajit, nuk mund të konsiderohet e ngjashme me Aktivitetin ne fjalë."

Arsyetimi i AK MPJ në Letrën Standarde të Tenderuesit të Eliminuar është në kundështim me Nenin 54 të LPP dhe Nenin 48 të Ligjit nr. 05/L-031 Për Procedurën e Pergjithshme Administrative (LPPA), sepse nuk përmban shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën Komisioni Vlerësues ka marrë vendim për refuzimin e kësaj dëshmie, dhe shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, prandaj duke u thirrur në Nenin 52 të LPPA, arsyetimi i pamjaftueshëm e bën Vendimin B58 të AK MPJ një Akt Administrativ të Paligjshëm.

Neni 54 i LPP, Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar

" 1.2. në rast të eliminimit të një tenderuesi që është eliminuar për shkak të parregullsive ose përndryshe tenderit të papërshtatshëm, njoftimi do të saktësojë mungesat në një tender të tillë."

Neni 48 i LPPA, Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim

"1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:

1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;

1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;

1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;

1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;

1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;

1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën ne dhënë në vendim.

2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë memungesën e tij."

Në FDT, tek pika 9.1 ("Kërkesat mbi mundësitë teknike") figuron kërkesa:

"Kërkesat:

1. OE-ik duhet të ofroj dëshmi Të mjaftueshme se ka realizuar projekte të ngjashme në tri vitet e fundit minimum120,000.00 euro (Pas korrigjimit të DT nga AK me datë 23.10.2023).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. OE duhet te plotësoj dhe dorëzoj një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te sherbimeve."

Për të dëshmuar përshtatshmërinë dhe përmbushjen e kërkesave teknike, Q.M "TEMA" O.P ka dorëzuar listën me kontratat e realizuara (Aneksi 6) në tri vitet e fundit para publikimit të NJK për punët e njejta/ngjashme, ndërsa në tabelë me nr. rendor 3. figuron kontrata 01K-61 (Nr. Prok. 656-19-2700-211) me titull "Transmetimi i drejtpërdrejtë i seancave të Kuvendit Komunal të Ferizajt", e realizuar nga data 21.08.2019 deri më 26.07.2021, me një vlerë prej 62,500.00 EURO, për të cilën është dorëzuar edhe referenca, mostrat dhe shkresat përcjellëse. (PROVË)

Në Aneksin 1 të FDT-së (Specifikimet Teknike të Detyrueshme), AK i ka radhitur shërbimet e kërkuara në formë tabelare, ndërsa tek kërkesat me numër rendor 16. dhe 17. ka kërkuar shërbimet e njejta me kohëzgjatje të ndryshme (1 orë dhe 5 orë) :

Lloji i shërbimit: "Regjistrimi dhe transmetimi i drejtpërdrejtë i konferencave"

Përshkrimi: "Regjistrimi dhe transmetimi i drejtpërdrejtë i një konference ose ngjarjeje në mediat sociale (Facebook, YouTube) në faqe të shumta FB. Xhirim me 2-3 kamera profesionale dhe dron (nëse kërkohet). Regjistrimi i videos dhe editim sipas nevojës në konsultim me MPJD. Materialet e xhiruara dorëzohen në MPJD për përdorim të përhershëm."

Gjatë fazës së vlerësimit, AK MPJ ka dërguar kërkesa për sqarim të tenderit, në të cilat jemi përgjegjur brenda afatit kohor, duke i ofruar AK MPJ edhe dokumentacionin shtesë sqarues (Të bashkangjitura si PROVA):

* Licencën për Transmetim Televiziv, të lëshuar nga KPM, në emër të Kompanisë Q.M. "TEMA" O.P., respektivisht TV TEMA;

* Kopjen e kontratës 01K-61 (Nr. Prok. 656-19-2700-211) me Komunën e Ferizajt;

* Faturat për transmetimin e drejtpërdrejtë të 25 seancave të KK Ferizaj;

* Përgjigjen e menagjeres së kontratës 01K-61 me sqarime shtesë në kërkesën tonë të parashtruar pranë Komunës Ferizaj për të detajuar natyrën e shërbimit të ofruar, mënyrën e realizimit të transmetimeve dhe platformat në rrjetet kabllore dhe sociale ku ky sinjal është transmetuar dhe ruajtur (dokumenti "Vërtetimi për realizimin e kontratës");

* Kopjen e Aprovimit CAA-0064-UAS të lëshuar nga Autoriteti Civil i Aviacionit të Kosovës në emër drejtorit të firmës, për fluturime me Sistem të mjetit Ajror pa Pilot -SAP (Dron);

* Disa kopje te aprovimeve të fluturimeve nga KFOR, lidhur me aktivitetet e xhirimeve me dron 4K për nevojat e MPJ gjatë realizimit të kontratës me nr. prok. 216-21-4498-2-3-6/C28 (e listuar në Aneksin 6);

* Broshurën me shënime dhe fotografi, ku AK-së i kemi ofruar sqarime për specifikacionet teknike të ofruara, kapacitetet teknike dhe profesionale/njerëzore të nevojshme për realizimin e transmetimeve të drejtëpërdrejta, si dhe portfolion e punëve të kaluara. Në këtë broshurë kemi theksuar plotësimin e kërkesave lidhur standardet e transmetimit dhe xhirimeve të cilat aplikohen në Kosovë dhe Europë:

a) Transmetimi në HD 1920 x1080 50i (me enkodim H.264) i sinjalit të miksuar tri apo më shumë kamerave përmes Regjisë Mobile (OBVAN) apo përmes enkoderëve IPTV- 4G

b) Xhirimet (Regjistrimet) në teknikën 4K përmes kamerave me standard filmik S-35mm

c) Xhirimet me dron 4K

d) Protokolet e enkodimit dhe platformat e internetit/rrjeteve sociale Facebook.com, Youtube.com, në të cilat realizohet transmetimi i drejtpërdrejtë i eventeve të ndryshme, konform kërkesave 16. dhe 17. në Aneksin 1 të DT.

e) Linqet e internetit, ku gjenden videot e transmetimeve të drejtpërdrejta dhe regjistrimet e realizuara nga kontratat/angazhimet e kaluara të kompanisë.

Në DT, AK nuk ka caktuar kërkesa specifike teknike lidhur me transmetimet e drejtpërdrejta, ashtu siç e parasheh Neni 28 i LPP-së në pikat 4 dhe 5, por vetëm ka ofruar një përshkrim narrativ të shërbimit se xhirimet dhe transmetimet duhet të realizohen "*në mediat sociale, në faqe të shumta në FB"* me 2-3 kamera profesionale. Në Letrën Standarde për tenderuesin e Eliminuar AK MPJ ka dështuar të elaborojë se cili është dallimi esencial ndërmjet kërkesave të parashtruara në Aneksin 1, për llojet e shërbimit nr. 16 dhe 17, me shërbimin e ofruar sipas Kontratës 01K-61 (Nr. Prok. 656-19-2700-211) e Komunës së Ferizajt, të sqaruar me provat shkresore përkatëse nga zyrtarët përgjegjës të Komunës së Ferizajt. AK duke mos ofruar prova që dëshmojnë se cilat janë devijacionet e papranueshme për të cilat Kontrata e transmetimit te drejtpërdrejtë te seancave të KK Ferizaj dallon ma Shërbimet e kërkuara nga AK MPJ, ky autoritet ka dështuar të që të arsyetojë refuzimin e referencës nga KK Ferizaj. AK ka deshtuar ta mbështesë arsyetimin qofte duke u thirrur ne ndonjë reference, standard teknik apo parametër teknik, qoftë përmes thirrjes ne Kodin Etik per Mediat apo ne çfarëdo parametri referent në mënyrë që ta mbështesë refuzimin e Referecës zyrtare nga një instutucion publik sic eshte Komuna e Ferizajt.

Për ne, refuzimi i tillë përveç se është arbitrar dhe i pabazuar në ligj, poashtu na jep dyshime të bazuara edhe për tejkalim të kompetencave nga ana e ZPP në MPJ.

Nëse i bëhet një vështrim krahasimor i kërkesave të AK të zbërthyera në detaje dhe dëshmive të ofruara nga OE Q.M"TEMA" O.P., Komisioni Vlerësues ka mundur të vërtetojë se kërkesat me nr. rendor 16 dhe 17 nga tabela e Aneksit 1në DT dhe shërbimi i ofruar nga Q.M TEMA O.P. për Komunën e Ferizajt, përveç se janë të ngjashme janë edhe identike (të njejta):

Aneksi 1 i DT, shërbimi nr. 16 dhe 17, i zbërthyer në detaje	**Kontrata 01K-61 (Nr. Prok. 656-19-2700-211), përshkrimi i shërbimit**	**Plotësimi i kërkesës**
"Regjistrim(Xhirim) dhe transmetim i drejtpërdrejtë i një konference ose ngjarjeje...	Xhirim dhe transmetim i drejtpërdrejtë i seancave të Kuvendit Komunal të Ferizajt. Seanca = ngjarje. **Provat shkresore dhe vizuele(video) - të dorëzuara.**	**Po, shërbim i njejtë -identik**
..në mediat sociale (Facebook, Youtube) në faqe të shumta FB.	Transmetim i drejtpërdrejtë në TV, në faqen e Facebookut të Televizioni TEMA dhe në kanalin Youtube, Share në faqen e Facebook të Komunës Ferizaj dhe në webfaqen e Komunës Ferizaj. **Provat shkresore dhe linqet aktive në internet – të dorëzuara në sqarim të tenderit,**	**Po, shërbim i njejtë -identik**
Xhirim me 2-3 kamera profesionale...	Xhirim i drejtpërdrejtë LIVE me 3 kamera me OB-VAN, rezolucion 1920x1080 50i. **Provat shkresore dhe linqet aktive në internet – të dorëzuara në sqarim të tenderit,**	**Po, shërbim i njejtë –identik**
..dhe dron(nëse kërkohet).	Kontrata 216-21-4498-2-3-6/C28 me MPJ, **Provat shkresore dhe linqet aktive në internet – të dorëzuara në sqarim të tenderit,**	**Po, shërbim i njejtë –identik**
Regjistrimi i i videos dhe editim sipas nevojës në konsultim me MPJD.	Kontrata 216-21-4498-2-3-6/C28 me MPJ, **Provat shkresore dhe linqet aktive në internet – të dorëzuara në sqarim të tenderit**	**Po, shërbim i njejtë –identik**
***Materialet e xhiruara dorëzohen në MPJD për përdorim të përhershëm.*"**	Dorëzimi i materialeve të xhiruara: a). në DVD (Kontrata **01K-61** me Komunën Ferizaj; b). DVD + Google Drive, Kontrata 216-21-4498-2-3-6/C28 me MPJ. **Provat shkresore të dorëzuara.**	**Po, shërbim i njejtë –identik**

Në Njoftimin për Kontratë, tek KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE "(III.3.1) Ekzekutimi I shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar)" AK MPJ e ka cilësuar Aktivitetin e Prokurimit nr. 216-23-10667-2- 2-1 si kontratë për shërbime që nuk janë rezervuara për një profesion, mirëpo me kërkesën për shërbim të "transmetimit" të drejtpërdrejtë, AK ka vendosur një kërkesë e cila është e rezervuar vetëm për subjektet juridike (OE) të licensuara nga KPM për transmetim të përmbatjeve audio vizuele në çfarëdo platforme elektronike.

Komisioni i Pavarur për Media, si institucion që ka mandatin ekskluziv kushtetues dhe ligjor për rregullimin e politikave të transmetimit dhe licensimin e subjekteve juridike transmetuese në Republikën

e Kosovës, specifikisht e ndalon veprimtarinë e transmetimit të palicensuar me Nenin 30 të Ligjit 04/L-044 për KPM.

Neni 30 i Ligjit 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media – Sanksionet " 5. Kushdo që operon pa leje transmetuese valide i konfiskohet aparatura përkatëse për transmetim. Subjekti i tillëtransmetues nuk mund të ankohet tek Bordi për Ankesa."

Duke e shpërblyer grupin e OE "MOVIOLA" L.L.C./Platform Advertising L.L.C. për shërbime që përfshijnë edhe transmetimin, si shërbim i caktuar ekskluzivisht për operatorë që janë të licensuar për transmetim nga KPM, dhe pa siguruar dëshmi se ky grup operatorësh e ka një licencë të tillë, përbën shkelje të Nenit 66 të LPP-së.

Neni 66 i LPP, Përshtatshmëria Profesionale

Nëse lëndë e aktivitetit të prokurimit është kontrata publike që përfshin ofrimin e shërbimeve profesionale, dhe nëse këto shërbime i takojnë llojit që normalisht mund të ofrohen vetëm nga operatori ekonomik që ka autorizimin ose licencën e autoritetit publik ose që është anëtar i organizatës së caktuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të ofrojnë dëshmi të arsyeshme se ata kanë autorizimin ose licencën e tillë ose se janë anëtarë në vendin e tyre të themelimit ose deklaratën nën betim se një kërkesë e tillë nuk ekziston në vendin e tyre të themelimit.

Pretendimi nr.3 - Diskriminimi i AK MPJ ndaj OE Q.M. "TEMA" O.P. dhe shpërblimi me kontratë i një grupi të OE të papërgjegjshëm dhe më të shtrenjtë, Nenet 6, 7, 56, 67 dhe 68 të LPP

a) Në Njoftimin për Kontratë dhe në FDT, në pikën 9.1 (Kërkesat për mundësitë teknike, dhe/ose Profesionale) AK MPJ në mënyrë shumë të qartë dhe specifike e ka vendosur kërkesën për dorëzimin e dëshmisë nga ana e OE:

"Dëshmia e kërkuar dokumentare:

2.Lista e personelit e nënshkruar dhe vulosur (a deri g), ..." Nëse i referohemi dosjes së tenderit të OE të shpërblyer me kontratë, grupit OE "MOVIOLA" L.L.C./Platform

Advertising L.L.C, në dokumentacionin e dorëzuar nga ky grup, e poashtu dhe në Formularin për Dorëzimin e Tenderit (B66) shihet qartë se mungon Lista e personelit e nënshkruar dhe e vulosur(a deri g) (PROVË). Duke e shpërblyer me kontratë OE i cili nuk e ka dorëzuar provën shkresore/dëshminë e kërkuar në NJK dhe FDT, AK MPJ ka vepruar në kundërshim me Nenin 67 të LPP, ndërsa duke e shpallur të përgjegjshëm këtë grup ekonomik pa i plotësuar kërkesat administrative, AK MPJ ka vepruar edhe në kundërshtim me Nenin 59 të LPP-së. Për të vërtetuar se kërkesa për këtë dëshmi ishte e qartë dhe e kuptueshme në Njoftimin për Kontratë dhe në FDT, shërben fakti se dy operatorë pjesëmarrës në këtë tender, Q.M. "TEMA" O.P. dhe N.SH "2B" në dosjet e tyre i kanë deponuar këto dëshmi në mënyrë të rregullt.

b) Qasja diskriminuese e AK MPJ ndaj OE Q.M "TEMA" O.P. dhe favorizuese ndaj OE "MOVIOLA" L.L.C./Platform Advertising L.L.C mund të konstatohet nga këto veprime:

b.1) Nga dokumentet e siguruara përmes qasjes në AK MPJ pas publikimit të Vendimit të AK, shihet se më datë

07.11.2023, me rastin e përgatitjes së Formularit për Vlerësimin e Tenderëve, AK ka larguar nga Raporti i Vlerësimit të Tenderëve (PROVË) kërkesën për Dëshminë 2.Lista e personelit e nënshkruar dhe vulosur (a deri g), .., me çrast ka bërë ndryshime të kërkesave themelore të përshtashmërisë pas hapjes së tenderit, duke i mundësuar grupit OE "MOVIOLA" L.L.C /Platform Advertising L.L.C. kalimin e testit (I pranueshëm) pranë Komisionit Vlerësues, përkundër faktit se ky grup operatorësh nuk ka

dorëzuar dëshminë e kërkuar në pikën 9.1 të FDT-së.

c) Në Njoftimin për Kontratë dhe në FDT, tek kërkesat "III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar" figuron kërkesa:

a. "Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet te ofroje dëshmi te kënaqshme Autoritetit kontraktues se qarkullimi vjetor (të hyrat) gjatë tri viteve (2020, 2021,2022) kanë qenë në shumë jo me pak se 180,000.00 €. "

Si dëshmi janë kërkuar:

"a. Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo ne vendin e themelimit." Nëse i referohemi dosjes së tenderit të OE të shpërblyer me kontratë, grupit OE "MOVIOLA" L.L.C./Platform Advertising L.L.C, në dokumentacionin e dorëzuar mungojnë deklaratat për qarkullimin vjetor të deklaruara në ATK për vitin 2021 dhe 2022, ndërkaq në tender janë deponuar 5 kopje të njejta dhe të njëpasnjëshme të deklaratës së vitit 2020 (PROVË). Komisionni Vlerësues e pranuar si dëshmi valide një dokument i cili nuk e dëshmon qarkullimin financiar të kërkuar me dokument të verifikueshëm (Deklaratat e ATK), duke vepruar kështu në kundërshtim me Nenin 68 të LPP-së.

Duke e shpallur të përgjegjshëm Në këtë mënyrë AK MPJ ka vepruar në kundërshtim me Nenin 56 të LPP dhe Nenin 7 të LPP-së, sepse ka krijuar kushte favorizuese për një operator dhe e ka shpallur të përgjegjshëm pa i plotësuar të gjitha kërkesat që janë të obligueshme sipas Nenit 56 të LPP-së.

OE Q.M. "TEMA" O.P. në dokumentacionin tenderues dhe në fazën e Sqarimeve të Tenderit, ka ofruar prova shkresore nga autoritetet publike të Kosovës dhe ka deponuar dosjet teknike të pajisjeve, licencën e KPM-së dhe autorizime ligjërisht obligative për realizmin e llojit të shërbimeve me nr. rendor 16. dhe 17. në Aneksin 1 të DT, në pajtueshmëri me standardet e transmetimit të programeve-audiovizuele në Kosovë, siç ishte rasti me transmetimin e seancave të Kuvendit Komunal të Ferizajt. Me provat shkresore të bashkangjitura, mostrat e dorëzuara dhe linqet aktive në internet (rrjete sociale dhe web), OE Q.M "TEMA" O.P. ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se ka ofruar shërbime profesionale të transmetimit në rezolucionin HDTV(High Definition TV), si standard i transmetimit në Kosovë i përkufizuar me Nenin 3.1.19 të Ligjit 05/L-27 Për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore.

Neni 3 i Ligjit Ligjit Nr.05/L-27 për Dixhitalimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore

1.19. Televizioni me kualitet të lartë HDTV - është shërbim që ofron fotografi dhe zë me cilësi më të lartë sesa cilësia standarde, duke i shtuar numrin e linjave analizuese për fotografi, duke ndryshuar metodën e analizës së fotografisë, duke e rritur proporcionin e faqeve të fotografisë në 16:9, si dhe duke i ndryshuar karakteristikat kolorometrike të fotografisë, në pajtim me rekomandimet relevante të Unionit Ndërkombëtar për Telekomunikacion (rekomandimet e ITU).

Në mungesë të specifikacioneve teknike të detajuara ne FDT apo Aneksin 1 të DT, OE Q.M " TEMA" O.P. përmes përgjigjes së datës 17.11.2023, ndaj Kërkesës për Sqarim të Tenderit, ka ofruar sqarime përmes të cilave Komisioni Vlerësues ka mundur të konstatojë se kushtet materiale të kërkesës së tenderit nuk kanë ndryshuar, dhe se dëshmia e ofruar në fjalë – Kontrata e shërbimeve të ofruara për Komunën e Ferizajt është identike me karakteristikat e parashtruara në Aneksin 1 të DT;

Duke e refuzuar si dëshmi valide Kontratën me Komunën e Ferizajt, AK MPJ ka vepruar edhe në kundërshtim me pikën 6 të Nenit 28 dhe pikën 4 të Nenit 59 të LPP.

Neni 28 i LPP - Specifikimet teknike

"..4. Autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të

Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian. (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim.

5. Nëse një standard i aplikueshëm, specifikim, ose miratim që kërkohet nga sipas paragrafit 4. nuk ekziston, ose nëse përdorimi i tij kërkon që autoriteti kontraktues të përdorë materiale ose produkte që nuk janë të përshtatshme me pajisjet që tashmë janë në dispozicion ose nëse përdorimi i tyre do të shkaktonte shpenzime të tepruara dhe të panevojshme, autoriteti i tillë kontraktues mund të përgatisë specifikacionin e tillë teknik duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës ose (ii) një miratimi teknik të Kosovës.

6. Nëse një tenderues mund të paraqet në tenderin e tij, përmes çfarëdo mase të duhur (siç janë, dosjet teknike ose raport testimi nga një palë e tretë e pavarur), se zgjidhja e propozuar nga tenderuesi në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesat e definuara në specifikim teknik, autoriteti kontraktues nuk mund të refuzoj tenderin me arsyetimin se produkti ose shërbimi i ofruar nuk përputhet me specifikimet teknike të formuluara duke iu referuar ndonjë specifikimi të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni. ..."

Neni 59 LPP, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

"4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve"

Pretendimi nr.2 – Shërblimi me kontratë i një OE të palicensuar për transmetim, Neni 21.1 i Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM, Neni 66 i LPP

Në Aneksin 1. Specifikimet e detyrueshme Teknike të DT, tek lloji i shërbimeve të kërkuara në tabëlë me numrat rendor 16. dhe 17. "Regjistrimi dhe transmetimi i drejtpërdrejtë i konferencave", figuron termi ligjor "transmetim", një shërbim audivizuel i cili definohet me Nenin 2.1.5 të Ligjit 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media (KPM).

Neni 2 i Ligjit 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media – Përkufizimet

1.5. Transmetim - emetimi burimor i programit me valë difuzive nëpërmjet të transmetuesit tokësor, rrjetit kabllor, transmetimit digjital, satelitor ose me pajisje të tjera elektronike, të koduar apo të pakoduar, që i destinohen për shfrytëzim publikut që pranohen me radio, televizion ose pajisje elektronike të veçanta për emetim, duke mos përfshirë komunikimet individuale;

Neni 21 Ligjit 04/L-044 për KPM - Licenca e transmetimit dhe ripërtëritja e tyre

1.Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja.

Neni 56 LPP, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

"Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe

përmes: 1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji; 1.2 së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji."

d) Në Raportin e Vlerësimit të Tenderëve, Komisioni Vlerësues ka gjetur se në mëyrë të gabuar se tenderi i OE Q.M. "TEMA" O.P është si i papajtueshëm me kërkesën për sigurimin e dëshmive për kryerjen e punëve të njejta/ngjashme në vlerë 180,000.00 EUR. Para hapjes, më 23.10.2023 AK e ka modifikuar këtë kërkesë dhe e ka ulur kërkesën e dëshmive në lartësi 120,000.00 EURO. Mosazhurnimi i formularit të Raportit për Vlerësimin e Tenderëve me kërkesën e ndryshuar 9.1 të FDT-së pas Korrigjimit të gabimeve ka cenuar të drejtën e kualifikimit përmes një kriteri i cili nuk ka qenë i vendosur para hapjes së tenderit. Kjo bie në kundërshtim me Nenin 24.7 të Rregullores Nr.001_2022 për Prokurimin Publik në të cilën thuhet:

Rregullore Nr.001_2022 Prokurimin Publik 24.7 Nëse para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, bëhet e nevojshme nga AK që të ndryshohet ose përmirësohet Dosja e Tenderit, Lista e çmimeve, të dhënat në njoftim për kontratë, të bëhet zgjatja e afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, atëherë ndryshimet ose përmirësimet nga AK bëhen vetëm duke përgatitur dhe publikuar Njoftimin për informata shtesë ose përmirësim gabime duke përdorur formularin standard B54.

e) Duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, jemi të bindur se AK MPJ ka vepruar me tendencë diskrimunuese ndaj OE Q.M. "TEMA" O.P., sepse më datë 13.11.2023 ka kërkuar me shkrim kopjet fizike të përshtatshmërisë, të cilat i kemi dorëzuar më datë 14.11.2023 dhe 15.11.2023. Kjo kërkesë na ka bërë të besojmë se më ose para datës 13.11.2023, Komisioni Vlerësues ka bërë një tjetër vlerësim dhe se ka shpallur kompaninë tonë si OE të rekomanduar për nënshkrim, pasiqë këto dokumente, bazuar në Rregulloren e Prokurimit Publik Nr.001_2022, si dhe në kërkesat 6.4 të DT, kërkohen vetëm nga operatorët e rekomanduar për kontratë.

Më datë 24.11.2023 kemi kërkuar nga AK që të na dërgojë kopjet e dokumentacionit fizik (Gjykata Ekonomike) të operatorëve të tjerë të eliminiuar/pasusksesshëm, por më datë 23.11.2023, AK ka dërguar vetëm ato të kompanisë së rekomanduar për nënshkrim, grupit Moviola L.L.C./ Platform Advertising L.L.C, duke vepruar në kundërshtim me Nenin 10 të LPP. Në kërkesën tonë për informacion apo raportet tjera(të mëhershme) të Vlerësimit të Komisionit, AK poashtu nuk ka kthyer përgjigje decidive dhe të qartë nëse ka pasur një takim të Komisionit Vlerësues para dates 20.11.2023.

" Rregullore Nr.001_2022 Prokurimin Publik 25.9 Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkohen të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblejë me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së."

Faza e Rishqyrtimit

Pretendimi Nr1. Në Vendimin e AK të datës 01.12.2023 për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, AK sërish ka dështuar të ofrojë arsyetinin e plotë dhe të qartë, si të specifikojë me prova se cilat janë dallimet esenciale në mes të shërbimeve të ofruara me Kontratën 01K-61 (Nr. Prok. 656-19-2700-211), dhe shërbimeve me nr.16 dhe 17 të Aneksit 1 të DT të AK MPJ. Duke mos u thirrur në asnjë provë, dëshmi, rrethanë apo specifikë tëknike apo profesionale, AK ka vepruar në mënyrë diskriminuese dhe në mënyrë të qëllimshme që ta eliminojë OE Q.M "TEMA" O.P. nga tenderi, përkundër të gjitha dëshmive, provave shkresore edhe vizuele të ofruara në tender dhe gjate fazes se sqarimeve te tenderit.

Pretendimi Nr.2 Në Vendimin e AK të datës 01.12.2023 për Refuzim të kërkesës për Rishqyrtim, tek pretendimi nr. 2, AK e hedh poshtë kërkesën tonë për rishqyrtim të vendimit si jashtë afatit.

Me këtë veprim, AK ka shkelur të drejtën tonë të kërkesës për rishqyrtim të vendimit të AK-së, sepse

Neni 108/A i LPP e garanton të drejtën tonë që si OE pjesëmarrës të parashtrojmë Kërkesë për Rishqyrtim për cilindo vendim dhe dokument paraprak të procedurës rrjedhëse (përfshirë këtu edhe njoftimin për kontratë dhe DT), dhe se kalimi i afatit për ankesë në dosjen e tenderit nuk e amniston AK që të vazhdojë procedurën e prokurimit me shkelje ligjore që konstatohen gjatë fazës së rishqyrtimit të vendimit, apo gjatë fazës së ankesave në OSHP, si dhe nuk e aminston AK MPJ që të vazhdojë me procedurë prokurimi dhe kontraktim i cili mund të shkaktojë një shkelje tjetër ligjore. Në këtë pikë, AK ka bërë edhe shkelje të Nenit 26.9 të Rregullores Nr.001/2022, sepse ka shpërblyer me kontratë një grup operatorësh i cili nuk ka ofruar dëshmi të jëtë i autorizuar ose i licencuar për transmetim të lëshuar nga Komisionii Pavarur i Mediave.

Neni 108/A LPP: 1. Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.

Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik "26.9 Nëse lënda e aktivitetit të prokurimit është kontrata publike që përfshinë ofrimin e shërbimeve profesionale dhe nëse këto shërbime i takojnë llojit që normalisht mund të ofrohen vetëm nga operatori ekonomik që ka autorizimin ose licencën, mjafton që njëri anëtar i grupit të ketë autorizimin, apo mjafton që njëri anëtar i grupit të jetë i licencuar dhe të dorëzoj dëshminë së bashku me dokumentet tjera të tenderit të grupit të operatorëve ekonomik në mënyrë që të konsiderohet se grupi e ka përmbushë këtë kërkesë si tërësi."

Pretendimi Nr.3 Në përgjigjen refuzuese të Këreksës soën për Rishqyrtim, AK sërish bë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, dhe ne mënyrë të gabuar vërteton se grupi OE "Moviola" LLC./Platfrom Advertising ka plotësuar të gjitha kërkesat e kualifikimit, duke e fshehur faktin se në FDT ka qenë kërkesë specifike që OE ta ofrojnë dëshminë e nënshkruar dhe të vulosur të listës së stafit pjesëmarrës në shërbimet e ofruara.

" FDT: (2.Lista e personelit e nënshkruar dhe vulosur (a deri g),"

Poashtu AK me përgjigjen e vet: "Pretendimi juaj lidhur me kapacitetin ekonomik financiar është i pabazuar pasi që në Ligjin Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TE REPUBLIKES SE KOSOVES, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092 (Versioni Konsoliduar) NENI 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare pika 1.1 e parasheh se mund të pranohen raportet përkatëse nga një ose më shumë banka", e vërteton se gjatë velrësimit ka bërë modifikim të kërkesës për ofrimin e deklarateve zyrtare nga ATK-ja, duke bërë ndryshimin materiale të kërkesave, në kundërshtim me Nenin 40 të Rregullores "Nr.001/2022" për Prokurimin Publik.

Neni 40 i LPP "Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

40.1 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP.

40.2 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti jepettenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqinkërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve."

KONKLUZË

Nga provat dhe dëshmitë e prezentuara, mund të konstatohet se Njoftimi (B58) për Vendimin e

Autoritetit Kontraktues "Ministria e Punëve të Jashtme" i publikuar më dt. 21.11.2023, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit nr. 216-23-10667-2-2- 1 me titull "Prodhimi i videove promovuese", është sjellur në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimit Publik;

Duke u bazuar në të gjitha provat dhe argumentet e cekura më lartë se Q.M "TEMA" O.P. nga Ferizaj i plotëson të gjithakriteret e përzgjedhjes dhe të dhënies së kontratës, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP që të anulojë Vendimin e Autoritetit Kontraktues MPJ dhe të merr këtë :

VENDIM

I. ANULOHET Njoftimi mbi Vendimin e (B58), i AK Ministria e Punëve të Jashtme, lidhur me aktivitetin e prokurimit Aktivitetin e Prokurimit me nr. 216-23-10667-2-2-1 me titull "Prodhimi i videove promovuese", i publikuar më dt.21.11.2023

II. Q.M."TEMA" O.P. SHPALLET: OPERATOR I PËRGJEGJSHËM

III. Q.M."TEMA" O.P. SHPALLET: OPERATOR EKONOMIK I REKOMANDUAR PËR NËNSHKRIM TË KONTRATËS.

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK), janë të pothuajse njëjta me kërkesa për rishqyrtim në autoritetin kontraktues kurse, tek Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet – janë te njëjta me atë të dorëzuar në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së - (me disa plotesime duke ruajtur pretendimet ankimore ne KpR).

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore)

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

Kërkesat: a. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet te ofroje dëshmi te kënaqshme Autoritetit kontraktues se qarkullimi vjetor (të hyrat) gjatë tri viteve (2020, 2021,2022) kanë qenë në shumë jo me pak se 180,000.00 €.	Dëshmia e kërkuar dokumentare:Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo ne vendin e themelimit.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional	**Dëshmia e kërkuar dokumentar.**
Kërkesat: 1. Operatoret ekonomik pjesëmarrës, duhet të kenë përfunduar kontrata për projekte të ngjashme, shuma e të cilave kanë qenë në vlerë jo me pak se 120,000.00 € , të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë.,	**Dëshmia e kërkuar dokumentare:** 1.OE duhet te plotësoj dhe dorëzoj një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te sherbimeve
Kërkesat: 2. OE-ik duhet të ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon a. Menaxheri I Projektit me 5 vite përvoje pune në këto fusha menaxhim të projekteve të prodhimit të videove të ngjashme, përvojë me raportin dhe menaxhim të buxheteve të projekteve publike, apo të ngjashme, duhet te dorëzoj Certifikaten për menaxhim (PMP) apo të ngjashme. b. Teknikë video dhe audio me 5 vite pervoje pune në këtë fushë Kamerë, Montazh ose Produksion, c.Person Krijues kreativ me 5 vite pervoje pune në këto fusha Dizajn grafik, dizajn multimedial, komunikim publik apo gazetari, dhe të ngjashme. d. Prodhues tePërmbajtjes me 5 vite përvoje pune në këtë fushë shkrim të përmbajtjes apo copy writter e. Person i angazhuar me 5 vite pervoje pune në këtë fushë Video, audio, montazh apo pas-prodhim të videos. f. Specialistë të IT dhe Rrjetit me 5 vite pervoje pune në këtë fushë transmetime live, rrjet, IT apo të ngjashme. g. Animator 2D dhe 3D me 5 vite pervoje pune në fushën e animacionit 2D & 3D;,	Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2. Lista e personelit e nënshkruar dhe vulosur (a deri g), për te gjithë personelin professional duhet te dorëzoj CV-te, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshjambi angazhimin për këtë projekt si dhe referencat perpërvojën e punës. Për menaxherin duhet te dorëzoj Certifikaten për menaxhim (PMP) apo të ngjashme**.**

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Nr.	Lloji i shërbimit	Përshkrimi	Njësia matëse

0	1	2	3
16	**Regjistrimi dhe transmetimi i drejtpërdrejtë i konferencave (1 orë)**	Regjistrimi dhe transmetimi i drejtpërdrejtë i një konference ose ngjarjeje në mediat sociale (Facebook, YouTube) në faqe të shumta FB . Xhirim me 2-3 kamera profesionale dhe dron (nëse kërkohet). Regjistrimi i videos dhe editim sipas nevojës në konsultim me MPJD. Materialet e xhiruara dorëzohen në MPJD për përdorim të përhershëm.	Për ngjarje event
17	**Regjistrimi dhe transmetimi i drejtpërdrejtë i konferencave (5 orë)**	Regjistrimi dhe transmetimi i drejtpërdrejtë i një konference ose ngjarjeje në mediat sociale (Facebook, YouTube) në faqe të shumta FB . Xhirim me 2-3 kamera profesionale dhe dron (nëse kërkohet). Regjistrimi i videos dhe editim sipas nevojës në konsultim me MPJD. Materialet e xhiruara dorëzohen në MPJD për përdorim të përhershëm.	Për ngjarje event
18	**Xhirim i videove udhëzuese**	Krijim dhe realizim i videove udhëzuese për një proces ose shërbim specifik, ku përfshihen sesione pyetjesh dhe përgjigjesh ose dokumentarë projektesh (p.sh., përmbledhja e arritjeve të projektit) ose Dokumentarët e profilit (p.sh. zgjedhja e disa intervistave të shkurtra nga jeta reale që regjistrohen dhe bashkohen në një video), apo video udhëzuese për shërbimet konsullore të ofruara nga MPJD. *Dorëzim i skenarit për çdo video projekt është i obliguar.*	Për/shërbim për projekt
19	**Post Video Produksion**	Video editim i xhirimeve ekzistuese dhe përshtatje për nevojat e ministrisë.	Për projekt
B	**Nentotali B peshimi 30%**		

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Komisioni ka kërkuar sqarime lidhur me çertifikaten e TVSH-së dhe OE-ik "Tema" ka dorëzuar sqarimet.

Komisioni ka kërkuar sqarime edhe për kontraten e Komunes Ferizajit OE-ik "Tema", por edhe pas pranimit te sqarimeve nga OE-ik, AK konstaton se nuk aktiviteti ne fjalë nuk mund te konsiderohet i ngjashëm me kërkesat e AK.

Komisioni rekomandon për dhënie OE-ik me çmimin më lirë TE PERGJEGJSHEM "Grupin e Operatoreve Ekonomik MOVIOLA L.L.C.; PLATFORM ADVERTISING L.L.C.,"

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

////

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

*(Të jepet një vlerësim se OE ankues është pale me interes sipas **nenit 4.1.26 të LPP-së**.)*

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Q.M. "Tema"**

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se pas analizës së provave, dëshmive dhe fakteve nga dokumentacioni i tenderit, kemi ardhur në konstatim se Komisioni Vlerësues i AK MPJ, në takimin e mbajtur më 20.11.2023, gjatë vlerësimit të ofertës sonë, ka bërë vërtetim të gabuar të provave dhe gjendjes faktike, duke e shpallur OE Q.M. "TEMA" O.P. si operator të papërgjegjshëm, në kundërshtim me Nenin 59 të LPP-së, përkundër faktit se tenderi i këtij operatori i ka plotësuar të gjitha kriteret e përzgjedhjes dhe dhënies, të parapara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të Tenderit. Në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, duke iu referuar mospërmbushjes së kërkesave për ofrim të dëshmive sipas Nenit 65, AK MPJ e jep këtë arsyetim: "Edhe pas sqarimeve të pranuara nga ana e juaj, nuk plotësoni kërkesën lidhur me aftësinë teknike dhe/ose profesionale. "OE-i duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar projekte te ngjashme në tri vitet e fundit në minimum 120,000 euro." Kontrata me Komunën e Ferizajit, nuk mund të konsiderohet e ngjashme me Aktivitetin ne fjalë." Për të dëshmuar përshtatshmërinë dhe përmbushjen e kërkesave teknike, Q.M "TEMA" O.P ka dorëzuar listën me kontratat e realizuara (Aneksi 6) në tri vitet e fundit para publikimit të NJK për punët e njejta/ngjashme, ndërsa në tabelë me nr. rendor 3. figuron kontrata 01K-61 (Nr. Prok. 656-19-2700-211) me titull "Transmetimi i drejtpërdrejtë i seancave të Kuvendit Komunal të Ferizajt", e realizuar nga data 21.08.2019 deri më 26.07.2021, me një vlerë prej 62,500.00 EURO, për të cilën është dorëzuar edhe referenca, mostrat dhe shkresat përcjellëse. (PROVË)

Në Aneksin 1 të FDT-së (Specifikimet Teknike të Detyrueshme), AK i ka radhitur shërbimet e kërkuara në formë tabelare, ndërsa tek kërkesat me numër rendor 16. dhe 17. ka kërkuar shërbimet e njejta me kohëzgjatje të ndryshme (1 orë dhe 5 orë) : Lloji i shërbimit: "Regjistrimi dhe transmetimi i drejtpërdrejtë i konferencave"

Përshkrimi: "Regjistrimi dhe transmetimi i drejtpërdrejtë i një konference ose ngjarjeje në mediat sociale (Facebook, YouTube) në faqe të shumta FB. Xhirim me 2-3 kamera profesionale dhe dron (nëse kërkohet). Regjistrimi i videos dhe editim sipas nevojës në konsultim me MPJD. Materialet e xhiruara dorëzohen në MPJD për përdorim të përhershëm." Gjatë fazës së vlerësimit, AK MPJ ka dërguar kërkesa për sqarim të tenderit, në të cilat jemi përgjegjur brenda afatit kohor, duke i ofruar AK MPJ edhe dokumentacionin shtesë sqarues (Të bashkangjitura si PROVA):

* Kopjen e kontratës 01K-61 (Nr. Prok. 656-19-2700-211) me Komunën e Ferizajt;

* Faturat për transmetimin e drejtpërdrejtë të 25 seancave të KK Ferizaj;

* Përgjigjen e menagjeres së kontratës 01K-61 me sqarime shtesë në kërkesën tonë të parashtruar pranë Komunës Ferizaj për të detajuar natyrën e shërbimit të ofruar, mënyrën e realizimit të transmetimeve dhe platformat në rrjetet kabllore dhe sociale ku ky sinjal është transmetuar dhe ruajtur (dokumenti "Vërtetimi për realizimin e kontratës");

d) Protokolet e enkodimit dhe platformat e internetit/rrjeteve sociale Facebook.com, Youtube.com, në të cilat realizohet transmetimi i drejtpërdrejtë i eventeve të ndryshme, konform kërkesave 16. dhe 17. në Aneksin 1 të DT.

Në DT, AK nuk ka caktuar kërkesa specifike teknike lidhur me transmetimet e drejtpërdrejta, ashtu siç e parasheh Neni 28 i LPP-së në pikat 4 dhe 5, por vetëm ka ofruar një përshkrim narrativ të shërbimit se xhirimet dhe transmetimet duhet të realizohen "*në mediat sociale, në faqe të shumta në FB"* me 2-3 kamera profesionale. Në Letrën Standarde për tenderuesin e Eliminuar AK MPJ ka dështuar të elaborojë se cili është dallimi esencial ndërmjet kërkesave të parashtruara në Aneksin 1, për llojet e shërbimit nr. 16 dhe 17, me shërbimin e ofruar sipas Kontratës 01K-61 (Nr. Prok. 656-19-2700-211) e Komunës së Ferizajt, të sqaruar me provat shkresore përkatëse nga zyrtarët përgjegjës të Komunës së

Ferizajt. AK duke mos ofruar prova që dëshmojnë se cilat janë devijacionet e papranueshme për të cilat Kontrata e transmetimit te drejtpërdrejtë te seancave të KK Ferizaj dallon ma Shërbimet e kërkuara nga AK MPJ, ky autoritet ka dështuar të që të arsyetojë refuzimin e referencës nga KK Ferizaj. AK ka deshtuar ta mbështesë arsyetimin qofte duke u thirrur ne ndonjë reference, standard teknik apo parametër teknik, qoftë përmes thirrjes ne Kodin Etik per Mediat apo ne çfarëdo parametri referent në mënyrë që ta mbështesë refuzimin e Referecës zyrtare nga një instutucion publik sic eshte Komuna e Ferizajt.

Nëse i bëhet një vështrim krahasimor i kërkesave të AK të zbërthyera në detaje dhe dështmive të ofruara nga OE Q.M"TEMA" O.P., Komisioni Vlerësues ka mundur të vërtetojë se kërkesat me nr. rendor 16 dhe 17 nga tabela e Aneksit 1në DT dhe shërbimi i ofruar nga Q.M TEMA O.P. për Komunën e Ferizajt, përveç se janë të ngjashme janë edhe identike (të njejta):

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, si dhe bazuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale **neni 9.1 & 9.2 të FDT-së**, si në vijim:

Kërkesat:1. Operatoret ekonomik pjesëmarrës, duhet të kenë përfunduar kontrata për projekte të ngjashme, shuma e të cilave kanë qenë në vlerë jo me pak se 120,000.00 € , të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë.,	**Dëshmia e kërkuar dokumentare:1.OE duhet te plotësoj dhe dorëzoj një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te sherbimeve**

OE ankues Q.M. "TEMA" O.P., me rastin e tenderimit për këtë aktivitet teprokurimit ka dorëzuar listën e kontratave sipas aneksit 6 te FDT-së, ku sipas numrit rendor ka prezantuar 9 (nëntë) kontrata, duke ju bashkangjitur referenca pozitive për realizimin e këtyre kontratave ne vlere totale: 178,778.05 €, ndërsa kontrata me nr. Rend. 3 – 01K-61 (Nr. prok. 656-19-2700-211) "Transmetimi drejtpërdrejt seancave te Kuvendit Komunal te Ferizajt" ne vlere: 62,500.00 € e cila edhe pas sqarimeve nga AK-komisioni i vlerësimit te datës: 15.11.2023 (letrës standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit përmes e-prokurimit) dhe sqarimeve te ofruar nga OE ankues te datës: 17.11.2023 AK – komisioni i vlerësimit, e refuzon me arsyetimin, po citoj: "*pas pranimit te sqarimeve nga OE-ik, AK konstaton se nuk aktiviteti ne fjalë nuk mund te konsiderohet i ngjashëm me kërkesat e AK*"., pa dhëne një përshkrim dhe arsyetim pse kjo kontrate nuk është e pranueshme, pasi qe nëse i referohemi edhe aneksit 1 te FDT-se pika 16 dhe 17 është pothuajse te njëjta me kontratën e prezantuar nga OE ankues dhe pesha e tyre është 30%, që do të thotë se komisioni i vlerësimit me mos arsyetim, pse kjo kontratë nuk është e pranueshme nga komisioni i vlerësimit si dhe ne refuzimin e kërkesën për rishqyrtim te datës 01.12.2023 nga ZPP, nuk është arsyetuar/argumentuar pse kjo kontratë nuk mund te pranohet si projekt i ngjashme, andaj me këtë veprim konsideroj se AK ka vepruar ne kundërshtim me **nenin 7 par. 2 të LPP-së**, ku thotë: "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik", si dhe **nenin 59 par. 4 të LPP-së**, ku thotë: "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*". Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

Përgjigje në pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se në Njoftimin për Kontratë, tek KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE "(III.3.1) Ekzekutimi I shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar)" AK MPJ e ka cilësuar Aktivitetin e Prokurimit nr. 216-23-10667-2- 2-1 si kontratë për shërbime që nuk janë rezervuara për një profesion, mirëpo me kërkesën për shërbim të "transmetimit" të drejtpërdrejtë, AK ka vendosur një kërkesë e cila është e rezervuar vetëm për subjektet juridike (OE) të licensuara nga KPM për transmetim të përmbajtjeve audio vizuele në çfarëdo platforme elektronike.

Komisioni i Pavarur për Media, si institucion që ka mandatin ekskluziv kushtetues dhe ligjor për rregullimin e politikave të transmetimit dhe licensimin e subjekteve juridike transmetuese në Republikën e Kosovës, specifikisht e ndalon veprimtarinë e transmetimit të palicensuar me Nenin 30 të Ligjit 04/L-044 për KPM.

Neni 30 i Ligjit 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media – Sanksionet

" 5. Kushdo që operon pa leje transmetuese valide i konfiskohet aparatura përkatëse për transmetim. Subjekti i tillëtransmetues nuk mund të ankohet tek Bordi për Ankesa."

Duke e shpërblyer grupin e OE "MOVIOLA" L.L.C./Platform Advertising L.L.C. për shërbime që përfshijnë edhe

transmetimin, si shërbim i caktuar ekskluzivisht për operatorë që janë të licensuar për transmetim nga KPM, dhe pa siguruar dëshmi se ky grup operatorësh e ka një licencë të tillë, përbën shkelje të Nenit 66 të LPP-së.

Neni 66 i LPP, Përshtatshmëria Profesionale

Nëse lëndë e aktivitetit të prokurimit është kontrata publike që përfshin ofrimin e shërbimeve profesionale, dhe nëse këto shërbime i takojnë llojit që normalisht mund të ofrohen vetëm nga operatori ekonomik që ka autorizimin ose licencën e autoritetit publik ose që është anëtar i organizatës së caktuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të ofrojnë dëshmi të arsyeshme se ata kanë autorizimin ose licencën e tillë ose se janë anëtarë në vendin e tyre të themelimit ose deklaratën nën betim se një kërkesë e tillë nuk ekziston në vendin e tyre të themelimit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit ka vepruar sipas kritereve te përzgjedhjes te përcaktuar ne dosje tenderit dhe njoftimin për kontrate, pasi qe licenca e transmetimit nuk ka qene kërkesë e FDT-se, andaj OE/tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, dhe OE ankues ka pas mundur te kërkoj sqarime shtese sipas **nenit 53 te LPP-së**, por një mundësi te tillë nuk e ka shfrytëzuar para hapjes se tenderëve, andaj ne këtë faze ne procesin e vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit te tenderëve, konsideroj se duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë **pikë nuk është i qëndrueshëm.**

Përgjigje në pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se diskriminimi i AK MPJ ndaj OE Q.M. "TEMA" O.P. dhe shpërblimi me kontratë i një grupi të OE të papërgjegjshëm dhe më të shtrenjtë, Nenet 6, 7, 56, 67 dhe 68 të LPP

a) Në Njoftimin për Kontratë dhe në FDT, në pikën 9.1 (Kërkesat për mundësitë teknike, dhe/ose Profesionale) AK MPJ në mënyrë shumë të qartë dhe specifike e ka vendosur kërkesën për dorëzimin e dëshmisë nga ana e OE:

"Dëshmia e kërkuar dokumentare:

2.Lista e personelit e nënshkruar dhe vulosur (a deri g), ..."

Nëse i referohemi dosjes së tenderit të OE të shpërblyer me kontratë, grupit OE "MOVIOLA" L.L.C./PlatformAdvertising L.L.C, në dokumentacionin e dorëzuar nga ky grup, e po ashtu dhe në Formularin për Dorëzimin e Tenderit (B66) shihet qartë se mungon Lista e personelit e nënshkruar dhe e vulosur (a deri g) (PROVË). Duke e shpërblyer me kontratë OE i cili nuk e ka dorëzuar provën shkresore/dëshminë e kërkuar në NJK dhe FDT, AK MPJ ka vepruar në kundërshim me Nenin 67 të LPP, ndërsa duke e shpallur të përgjegjshëm këtë grup ekonomik pa i plotësuar kërkesat administrative, AK MPJ ka vepruar edhe në kundërshtim me Nenin 59 të LPP-së. Për të vërtetuar se kërkesa për këtë dëshmi ishte e qartë dhe e kuptueshme në Njoftimin për Kontratë dhe në FDT, shërben fakti se dy operatorë pjesëmarrës në këtë tender, Q.M. "TEMA" O.P. dhe N.SH "2B" në dosjet e tyre i kanë deponuar këto dëshmi në mënyrë të rregullt.

b) Qasja diskriminuese e AK MPJ ndaj OE Q.M "TEMA" O.P. dhe favorizuese ndaj OE "MOVIOLA" L.L.C./Platform Advertising L.L.C mund të konstatohet nga këto veprime:

b.1) Nga dokumentet e siguruara përmes qasjes në AK MPJ pas publikimit të Vendimit të AK, shihet se më datë

07.11.2023, me rastin e përgatitjes së Formularit për Vlerësimin e Tenderëve, AK ka larguar nga Raporti i Vlerësimit të Tenderëve (PROVË) kërkesën për Dëshminë 2.Lista e personelit e nënshkruar dhe vulosur (a deri g), .., me çrast ka bërë ndryshime të kërkesave themelore të përshtashmërisë pas hapjes së tenderit, duke i mundësuar grupit OE "MOVIOLA" L.L.C /Platform Advertising L.L.C. kalimin e testit (I pranueshëm) pranë Komisionit Vlerësues, përkundër faktit se ky grup operatorësh nuk ka dorëzuar dëshminë e kërkuar në pikën 9.1 të FDT-së.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, si dhe bazuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale **neni 9.1 & 9.2 të FDT-së**, si në vijim:

Kërkesat: 2. OE-ik duhet të ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon a. Menaxheri I Projektit me 5 vite përvoje pune në këto fusha menaxhim të projekteve të prodhimit të videove të ngjashme, përvojë me raportin dhe menaxhim të buxheteve të projekteve publike, apo të ngjashme, duhet te dorëzoj Certifikatën për menaxhim (PMP) apo të ngjashme. b. Teknikë video dhe audio me 5 vite përvojëpune në këtë fushë Kamerë, Montazh ose Produksion, a. Person Krijues kreativ me 5 vite përvojë pune në këtofusha Dizajn grafik, dizajn multimedial,	Dëshmia e kërkuar dokumentare:2. Lista e personelit e nënshkruar dhe vulosur (a deri g), për te gjithë personelin professional duhet te dorëzoj CV-te, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt si dhe referencat për përvojën e punës. Për menaxherin duhet te dorëzoj Certifikatën për menaxhim (PMP) apo të ngjashme.

komunikim publik apo gazetari, dhe të ngjashme. d. Prodhues tePërmbajtjes me 5 vite përvoje pune në këtë fushë shkrim të përmbajtjes apo copy writter e. Person i angazhuar me 5 vite pervoje pune në këtë fushë Video, audio, montazh apo pas-prodhim të videos. f. Specialistë të IT dhe Rrjetit me 5 vite pervoje pune në këtë fushë transmetime live, rrjet, IT apo të ngjashme.g. Animator 2D dhe 3D me 5 vite pervoje pune në fushën e animacionit 2D & 3D;,	

GOE i rekomanduar për dhënie te kontratës **"MOVIOLA" L.L.C. & Platform Advertising L.L.C** me rastin e tenderimit nuk ka dorëzuar listën e stafit/personelit te nënshkruar dhe te vulosur (a deri g), ashtu siç është kërkuar ne FDT-së sikurse me larte, kurse komisioni i vlerësimit ne raportin e datës 11.11.2023 e vlerëson ne "Pajtim" (*ne raportin e vlerësimit platforma elektronike e-prokurim paraqet vetëm kërkesat e dosjes se tenderit, por jo edhe dëshmitë*), ndërsa ZPP ne refuzimin e KpR te OE ankues jap ketë sqarim: "*GOE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka dorëzuar te gjitha dëshmitë e stafit e paraqitur ne ofertë po ashtu vlen te cekët se ne formularin e tenderit i cili krijohet nga platforma elektronike e-prokurimi janë listuar i gjithë stafi i cili do te jete i angazhuar për projektin në fjalë*", andaj konsideroj se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk ka dorëzuar listën e stafit/personelit te nënshkruar dhe te vulosur, që do të thotë se komisioni i vlerësimit ne raportin e tij tek deklarata deatal - nuk e ka arsyetuar/trajtuar sipas **nenit 59 par. 4 të LPP-së**, ku thotë: *(i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve*., duke pas parasysh këto sqarime si me lartë, konsideroj se është përgjegjësi e AK - komisionit te vlerësimit këtë çështje te trajtoj si devijim i vogle qe nuk do te ndikoj ne aspektin e tenderit, pasi qe edhe pse mungon lista e nënshkruar dhe vulosur stafi/personelit e cila është prezantuar sipas kërkesë, por jo edhe sipas dëshmisë se kërkuar te FDT-se, konsideroj se duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë **pikë është pjesërisht i qëndrueshëm.**

Përgjigje në pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se nëse i referohemi dosjes së tenderit të OE të shpërblyer me kontratë, grupit OE "MOVIOLA" L.L.C./Platform Advertising L.L.C, në dokumentacionin e dorëzuar mungojnë deklaratat për qarkullimin vjetor të deklaruara në ATK për vitin 2021 dhe 2022, ndërkaq në tender janë deponuar 5 kopje të njëjta dhe të njëpasnjëshme të deklaratës së vitit 2020 (PROVË). Komisioni Vlerësues e pranuar si dëshmi valide një dokument i cili nuk e dëshmon qarkullimin financiar të kërkuar me dokument të verifikues (Deklaratat e ATK), duke vepruar kështu në kundërshtim me Nenin 68 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, si dhe bazuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale **neni 9.1 & 9.2 të FDT-së**, si në vijim:

Kërkesat:	**Dëshmia e kërkuar dokumentare:**
a. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet te ofroje dëshmi te kënaqshme Autoritetit kontraktues se qarkullimi vjetor (të hyrat) gjatë tri viteve (2020, 2021,2022) kanë qenë në shumë jo me pak se 180,000.00 €.	a. Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo ne vendin e themelimit.

Lideri i GOE te rekomanduar për dhënie te kontratës **"MOVIOLA" L.L.C.** ka dorëzuar CD-formularin e deklarimit vjetor dhe pagesave për tatim ne te ardhurat e korporatave – Deklarata nga ATK-ja vetëm për vitin 2020 ne vlere: **29,980.00 euro**, ndërsa për vitet tjera i mungojnë, por ka dorëzuar qarkullim nga Banka Raiffeisen për vitet (2021, 2022, 2023) ne vlere: **174,371.16 euro**, kurse anëtari i grupit: **Platform Advertising L.L.C**., ka dorëzuar qarkullim nga banka TEB për përudhen (01.01.2021 – 16.08.2023) ne vlere: **260,736.69 euro**, mirëpo marr për bazë qe AK kontraktues, ne dosje tenderit dhe ne njoftimin për kontrate ka kërkuar qarkullimin përmes Administratës Tatimore e Kosovës dhe jo përmes bankës pavarisht qe **neni 68 i LPP-së** ku thote: *"Në përgjithësi, operatorëve ekonomik u lejohet të plotësojnë këtë kërkesë duke paraqitur, nëse është me rëndësi dhe e nevojshme, një ose më shumë nga referencat e dhëna në vijim:*

1.1. raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka;

1.2. evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve;

1.3. kopjet e certifikuara të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilancet e gjendjes nëse kërkohet publikimi i bilanceve të tillë të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të operatorit ekonomik; ose

1.4. kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur; ose

1.5. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.

Atëherë marr për bazë se AK – ZPP ka specifikuar qe qarkullimi duhet te dëshmohet përmes ATK-së, si dhe vlerësimi, ekzaminimi dh krahasimi i tenderëve behet sipas kritereve te përzgjedhjes te përcaktuar ne dosje tenderit dhe njoftimin për kontrate,si dhe duke marr për baze kërkesën e dosjes se tenderit si me lart, atëherë konsideroj se AK- komisioni i vlerësimit ka mund te kërkoj sqarime shtese sipas **nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së**, (ne mënyrë qe te sigurohet se qarkullimi financiare e plotësojnë kërkesën e FDT-së). Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në **këtë pikë është i qëndrueshëm.**

<u>Përgjigje në pretendimi nr. 5</u>

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se AK MPJ ka vepruar me tendencë diskrimunuese ndaj OE Q.M. "TEMA" O.P., sepse më datë 13.11.2023 ka kërkuar me shkrim kopjet fizike të përshtatshmërisë, të cilat i kemi dorëzuar më datë 14.11.2023 dhe 15.11.2023. Kjo kërkesë na ka bërë të besojmë se më ose para datës 13.11.2023, Komisioni Vlerësues ka bërë një tjetër vlerësim dhe se ka shpallur kompaninë tonë si OE të rekomanduar për nënshkrim, pasiqë këto dokumente, bazuar në Rregulloren e Prokurimit Publik Nr.001_2022, si dhe në kërkesat 6.4 të DT, kërkohen vetëm nga operatorët e rekomanduar për kontratë.

Më datë 24.11.2023 kemi kërkuar nga AK që të na dërgojë kopjet e dokumentacionit fizik (Gjykata Ekonomike) të operatorëve të tjerë të eliminuar/pasuksesshëm, por më datë 23.11.2023, AK ka dërguar

vetëm ato të kompanisë së rekomanduar për nënshkrim, grupit Moviola L.L.C./ Platform Advertising L.L.C, duke vepruar në kundërshtim me Nenin 10 të LPP. Në kërkesën tonë për informacion apo raportet tjera (të mëhershme) të Vlerësimit të Komisionit, AK po ashtu nuk ka kthyer përgjigje decidive dhe të qartë nëse ka pasur një takim të Komisionit Vlerësues para datës 20.11.2023.

" Rregullore Nr.001_2022 Prokurimin Publik

25.9 Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkohen të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblejë me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së."

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, si dhe bazuar ne sqarimet e ofruar nga AK – ZPP (MPJ), pasi qe me datën 13.11.2023 AK përmes e-mail-i ka kërkuar me shkrim kopjet fizike të përshtatshmërisë, te cilat OE ankues i ka sjellë me date 14.11.2023, mirëpo edhe për kundërti kësaj AK me datën 15.11.2023 ka kërkuar sqarime shtese përmes letrës standard te kërkesës për sqarimin e tenderit te datës 15.11.2023 dhe pas sqarimeve te pranuar nga OE ankues AK – komisioni i vlerësimit e shpallë te pa-përgjegjshëm, sikur kam sqaruar ne **pretendimin nr. 1** te këtij raporti, kurse lidhur me kufizimin e qasjes ne dokumentet sipas **nenit 10 të LPP-së**, OE ankues ka kërkuar sqarim përmes e-mail-i me date: 22.11.2023 ku thotë: "*Minutat/procesverbalin nga te dyja takimet e Komisionit Vlerësues, meqenëse ne Raportin e Vlerësimit te Datës 21.11.2023, nuk ka shënime për diskutimet e anëtareve te Komisionit*", ndërsa AK – ZPP përmes e-mail-i me date 22.11.2023jap këtë sqarim si ne vijim: "*Raportin e vlerësimit ua kemi dorëzuar me herët me USB, në të cilin janë përfshirë të gjitha komentet e anëtarëve të komisionit , pasi që kanë qenë të gjithë të dakorduar lidhur me vlerësimin. Ndërsa deklaratën e disponueshmërisë po ua përcjell tani"*, po ashtu me datën 27.11.2023 AK përmes e-mail-i i dërgon ne attach. dëshmitë e pranushmerisë për GOE te rekomanduar për kontrate duke i jap qasje OE ankues, prandaj konsideroj se duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese lidhur me qasje ne dokumente në këtë **pikë nuk është i qëndrueshëm.**

Gjithashtu, pas sqarimeve te kërkuar nga AK dhe pranime e sqarimeve me date: 18.12.2023, **Eksperti Shqyrtues Sqaron**, se AK me date 13.11.2023 përmes e-mail-i i kërkon dokumentet e pranueshmërisë për OE ankues, kurse OE ankues këto dokumente i derëzën me datën 14.11.2023 bazuar në Rregulloren e Prokurimit Publik Nr.001_2022, si dhe në kërkesat 6.4 të DT, kërkohen vetëm nga operatorët e rekomanduar për kontratë, ky pretendim është i bazuar pasi qe AK – Komisioni i vlerësimit – ZPP krejt pas kësaj kanë kërkuar sqarime tjera shtese dhe kane rekomanduar për dhënie te kontratës GOE: Moviola L.L.C./ Platform Advertising L.L.C, ashtu siç kam sqaruar ne pretendimin nr. 1.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, **nuk ka respektuar nenin 7, 54, 56, 59, 60 të LPP-së**, andaj **Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit– ZPP,** që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore të LPP-së, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 dhe ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe

burimeve publike.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të aprovohet si e bazuar**, (*për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet si më lartë*)dhe rekomandon që të anulohet B58-njoftimit mbi vendimin AK (*vendimit për dhënie të kontrates*) dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim.**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Q.M. "Tema"**

Sahit Beqiri